



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Vlora Mjekiqi Kabashi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<i>Per:</i> Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Data: 09.06.2025 Nr. 020-315
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Kryetarit të Komunës 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Obiliqit	

I nderuar Kryetar,

E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi nr. 01-060-01-13276-25 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.
I miratuar më datë: 16.05.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 20.05.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës.

Arsyetim

Kuvendi i komunës së Obiliqit në mbledhjen e mbajtur me datë 16.05.2025, ka miratuar Vendimin nr. 01-060-01-13276-25 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL konstaton se akti i miratuar nga kuvendi i komunës së Obiliqit, është bazuar në nenin 12, 14 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 8 pika 1.3 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe neni 23 i Rregullorës (QRK) nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimi është miratuar në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës së Obiliqit e mbajtur me datë 16.05.2025, është miratuar me 12 vota për, 5 kundër dhe 0 abstenime.

Neni 23 pika 1 i Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, përcakton se:

1. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshë lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Xhafer Gashi, gradonačelnik opštine Obilić Vlora Mjekiqi Kabashi, predsedavajuća Skupštine opštine Obilić
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Jeton Qela, generalni sekretar u MALS-u
Od:	Erbilin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja u MALS-u
Službenik-ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za razmatranje zakonitosti akata skupština opština i gradonačelnika opštine
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Martin Shala, viši službenik za razmatranje zakonitosti akata opštine
Predmet:	Zahtev za razmatranje akta opštine Obilić
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine

Poštovani gradonačelnice,
Poštovana predsedavajuća,

U skladu sa članom 9, Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka br. 01-060-01-13276-25 o davanju na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine.
Usvojena dana, 16.05.2025.
Podnošena na razmatranje u MALS_U dana, 20.05.2025.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.
Dok, što se tiče sadržaja akta i obaveza prema drugim stranama su u nadležnosti opština

Obrazloženje

Skupština opštine Obilić, na sednici održanoj dana, 16.05.2025. godine, usvojila je Odluka br. 01-060-01-13276-25 o davanju na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine.

MALS, konstatuje da je akt koji je usvojila Skupština opštine Obilić zasnovan na članu 12, 14. i članu 58. tačka (h) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 8. tačka 1.3 i članu 11. Zakona br. 06/L-092, o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 5 stav 1 podstav 1.3 i članu 23 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupka za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine.

Odluka je usvojena na redovnoj sednici Skupštine opštine održanoj dana, 16.05.2025. godine, sa 12 glasa "za" 5 "protiv" i 0 "uzdržanih".

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.